



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivered	23.05.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	2986/2022		14



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.353/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Malsore Gashi Bajraktari- Kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca- anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.353/2022 e datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit Komuna e Skenderajt, në çështjen juridike “Vërejtje”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.353/2022 e datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Anulohet masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” e datës 25.03.2022 me numër 02-116/04-0013398/22 e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Skenderaj.

III. OBLIGOHET Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Skenderaj, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerrë vendim për fshirjen e “Vërejtje me shkrim” e datës 25.03.2022 me numër 02-116/04-0013398/22 e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Skenderaj.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt emërimit me numër 02-112/01-0009527/20 të datës 20.02.2020 ankuesi është i sistemuar në vendin e punës “Përfaqësuesi Ligjor”, në Drejtorin/Njesisë e Zyrës së Kryetarit, të cilit me datë 25.03.2022 me numër 02-116/040013398/22 Kryetari i Komunës ia ka shqiptuar “Vërejtjen me shkrim” me arsyetim me mos respektimin e orarit të punës.

Ankuesi i pa kënaqur me vërejtjen me numër 02-116/040013398/22 të datës 25.03.2022 të Kryetarit të Komunës së Skenderaj, me datë 08.04.2022 parashtron ankesën me numër të protokollit 1987/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ka përcjell ankesën e ankuesit tek organi i punësimit Komuna e Skenderaj ndërsa me datë 29.04.2022, me numër protokollit 2515/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Skenderajt, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 08.04.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtja e datës 25.03.2022; Fjala Përfundimtare e datës 25.03.2022; Procesverbalet e seancës përgatitore e datave 28.02.2022, 24.03.2022 e Gjykatës Themelore Mitrovicë/Dega e Gjykatës Skenderaj; Ankesë e datës 24.03.2022 e parashtruar në Gjykatën e Apelit të Kosovës; Akt emërimi i ankuesit i datës 20.02.2022; Raporti i prezencës në punë për datën 25.03.2022; Autorizimi i datës 26.11.2018 për publikimin e konkursit për vendin e punës "Përfaqësues Ligjor i Komunës" si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili e ka kontestuar vërejtjen e datës 25.03.2022 e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Skenderaj me arsyetim për mos respektim të orarit të punës duke shtuar se ditën e shqiptimit të vërejtjes më shkrim ka qenë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë/Dega Skenderaj për fjalën përfundimtare për rastin me numër C.nr.53/2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet kryesore të ankuesit sa i përket "Vërejtje me shkrim" e datës 25.03.2022 me numër 02-116/04-0013398/22 e shqiptuar nga Kryetari i Komunës së Skenderaj dhe duke u bazuar në provat e administruara në lidhje me këtë lëndë, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuara mbi bazë të arsyeve të specifikuara si më poshtë.

Bazuar në provat e lëndës, respektivisht në përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Përfaqësues Ligjor" janë përcaktuar detyrat kryesore të punës si: **1. Bashkëpunon me organet judikaturës dhe organet komunale; 2. Jep mendime juridike, profesionale dhe rekomandimet tjera në përmbushjen e ligjshmërisë sa i përket organeve komunale; 3. Paraqet raport mbi punën dhe detyrat nga fushë veprimtari a e vet me qëllim të mbrojtjes së interesave të komunës; 4. Bënë përfaqësimin e komunës para gjykatave; 5. Bënë të gjitha autorizimet për përfaqësim në gjykatë; 6. Regjistron ankesat në gjykata në emër të Komunës; 7. Për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të Komunës, raporton Kuvendit Komunal; 8. Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinion ligjor si dhe bënë hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar pasi që vërejtja e dhënë me shkrim e datës 25.03.2022 nga Kryetari i

Komunës së Skenderaj nuk është bazuar në provat dhe faktet lidhur me mos respektimin e orarit të punës rrjedhimisht mos prezencës në punë nga ankuesi pasi që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës respektivisht në Procesverbalin e Seancës Kryesore të datës 23.03.2022 të Gjykatës Themelore Mitrovicë/Dega e Gjykatës Skenderaj gjegjësisht në faqen katër (4) paragrafi 3 të procesverbalit, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është deklaruar se: *"fjalën përfundimtare në mënyrë të detajuar do tia dorëzojmë kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën paditëse në afat prej 7 dite"*, dhe se nga provat e lëndës rezulton se ankuesi me datë 25.03.2022 në ora 15:50 ka dorëzuar fjalën përfundimtare në Gjykatën Themelore në Mitrovicë/Dega Skenderaj dhe se nga raporti i prezencës në punë për datën 25.03.2022 nga sistemi i menaxhimit të hyrje-daljes në punë shihet se ankuesi pas pauzës ka qenë në teren sipas opsionit të zgjedhjes së klikimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe dëshmime të ofruara në lëndë, konstaton se Kryetari i Komunës së Skenderajt, me rastin e shqiptimit të „vërejtjes me shkrim“ për ankuesin nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike duke mos i konstatuar drejt elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht nuk ka konstatuar saktë përgjegjësin disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, e që në rastin konkret, Kryetari i Komunës së Skenderajt, nuk ka arritur të konstatoj saktë kohen se kur ankuesi nuk ka qenë në vendin e tij të punës, po ashtu nuk ka bërë përpjekjeje për te biseduar me ankuesin lidhur me mungesën e tij në vendin e punës dhe nuk ka bërë përpjekje për të verifikuar dëshmitë konkretisht sistemin elektronik të vijueshmërisë në puna të ankuesit, por në mënyrë të përgjithshme ju ka referuar dispozitës së lartcekur andaj me të drejte Kolegji konstaton se Kryetari i Komunës së Skenderajt, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit përveç që nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike ai nuk ka arritur te vërtetoj as gjendjen juridike. Po ashtu Kolegji ka konstatuar se "Vërejtja" e datës 25.03.2022 nuk e ka arsyetimin e një akti administrativ me shkrim, i cili do të duhej të ishte i bazuar në dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *"1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:.....2.shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi"*, që në rastin konkret Kryetari i Komunës së Skenderaj i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore „vërejtje“ të datës 25.03.2022, nuk ka marrë për bazë këto dispozita ligjore dhe se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë çështje juridike është i bazuar, nga se në rastin konkret në bazë të provave të lëndës këto dispozita nuk janë marrë parasysh me rastin e shqiptimit të kësaj vërejtje.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që masa disiplinore „vërejtje me shkrim“ e datës 25.03.2022 me numër 02-116/040013398/22 e shqiptuar ndaj ankuesit përveç që është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publike është në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafi 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton

gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryetari i Komunës së Skenderajt dhe Menaxheri i Personelit, janë të obliguar që të bëjnë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë shuarjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit respektivisht masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit "Vërejtje" e datës 25.03.2022 nga Kryetari i Komunës së Skenderaj duhet të fshihet nga dosja personale dhe regjistri përkatës në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 51 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.353/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Skenderaj;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Skenderaj dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

